



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 12, datë 27.02.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike, të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se duke filluar nga data 24 Qershor 2020 e në vazhdim, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) do të zhvillohet testimi i informatizuar për punësimin e mësuesve.

Kalendari me shpërndarjen sipas profileve dhe listat emërore me oraret për çdo kandidat do të publikohen në ditët në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al.

Testimi i informatizuar do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH).

Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe në vijim të masave parandaluese të përhapjes së tij, nëpërmjet urdhrave të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, testimet do të zhvillohen duke zbatuar me përpikmëri rregullat e mëposhtme.

Qendra e Shërbimeve Arsimore është përgjegjëse për ofrimin e sigurisë maksimale dhe kushteve të përshtatshme higjieno - sanitare, duke ofruar:

- *pastrim dhe dezinfektim të ambienteve të testimit me solucione dezinfektuese të miratuara, përpara dhe pas çdo seance testimi;*
- *pastrim dhe dezinfektim të pajisjeve fizike të ambienteve të testimit, si: kompjuterët, pajisjet elektronike, karriket, tavolinat etj.;*
- *vendosje të solucioneve dezinfektuese në hyrje të çdo ambienti testimi;*
- *respektim të distancës 1,5 – 2 metër ndërmjet kandidatëve gjatë gjithë proceseve të zhvillimit të testimit;*
- *mundësinë e kryerjes së testimit në kabina të veçanta për secilin kandidat, duke respektuar distancën fizike nga njëri – tjetri;*
- *pajisjen me mjetet e dhura mbrojtëse si, maska dhe doreza plastike, të stafit të institucionit dhe personave të jashtëm, të përfshirë në proceset e zhvillimit të testimit.*

Gjatë paraqitjes për pjesëmarrje në testim, kandidati duhet të ketë parasysh dhe të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- 1. të paraqitet pranë QSHA-së i pajisur me mjetet mbrojtëse, maskë dhe doreza plastike;*
 - 2. të zbatojë ruajtjen e distancës fizike 1,5 – 2 metër me kandidatët e tjerë;*
 - 3. të ketë me vete **vetëm** dokumentet e kërkuara dhe mjetin e identifikimit;*
 - 4. të ketë me vete stilolaps për nënshkrimin e deklaratës dhe rezultatit të testimit;*
 - 5. të mos ketë me vete celularë, çanta dhe sende të tjera personale, të panevojshme në zhvillimin e testimit.*
6. Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA **30 minuta përpara** orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:
- Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
 - Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
 - Formularin e pjesëmarrjes në testimin e informatizuar, të lëshuar nga komisioni i vlerësimit të dosjeve në DRAP.

Kandidatët, të cilët nuk paraqesin këto dokumente, nuk mund të marrin pjesë në testimin e informatizuar.

7. Kandidati duhet të mbajë parasysh sa më poshtë:
- Ndalohet **marrja me vete** dhe **përdorimi i celularëve** dhe mjeteve të tjera të komunikimit, gjatë zhvillimit të testimit, pasi ky vlerësohet si kriter skualifikimi;
 - Ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të testimit;
 - Ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e testimit.

Për të gjithë kandidatët e regjistruar, lutemi të verifikoni paraprakisht emrin, mbiemrin, profilin, si dhe orarin e testimit në faqen zyrtare të QSHA-së, në adresën www.qsha.gov.al, “Provimet e Shtetit”, rubrika “Njoftime”, “Lista e kandidatëve për testimin e informatizuar.”. Në rast pasaktësish kandidatët duhet t’i drejtohen DRAP/ZVA përkatëse.

Ju bëjmë me dije se, në lidhje me orarin e pjesëmarrjes në testim, oraret do të jenë të përcaktuara për çdo kandidat dhe nuk do të ketë ndryshime orari përtej planifikimit të publikuar në faqen zyrtare të QSHA.

Ju urojmë Suksese !